<p>Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njërive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta</p>		
Kodi i programit	Përshkrimi i funksionit	Përshkrimi i funksionit
10430	Përkujdesi social	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;</li> <li>• Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;</li> <li>• Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;</li> <li>• Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);</li> <li>• Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;</li> <li>• Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje);</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;</li> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.);</li> <li>• Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;</li> <li>• Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj;</li> <li>• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuara;</li> </ul> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);</li> <li>• Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor;</li> <li>• Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit;</li> <li>• Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.</li> </ul> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit;</li> <li>• Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.);</li> <li>• Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore.</li> </ul> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm;</li> </ul>
--	---

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë;</li> <li>• Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje;</li> <li>• Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës;</li> <li>• Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre;</li> </ul>
--	--	--

#### **Qëllimi i Politikës së Programit**

- Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

#### **Objektivi i Politikës së Programit**

- Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

#### **Objektivi i Politikës së Programit**

- Femije qe ndjekin çerdhen.

### **FUNKSIONI STREHIMI SOCIAL**

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.		
Kodi i programit	Përshkrimi i funksionit	Përshkrimi i aktiviteteve të funksionit
10661	Strehimi social	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;</li> <li>• Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</li> <li>• Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;</li> <li>• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit;</li> <li>• Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;</li> <li>• Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;</li> </ul>

### **Qëllimi i Politikës së Programit**

- Rikonstruksioni i banesave me kushte të papërshtatshme për grupet e pafavorizuara dhe trajtim me bonus qeraje.

### **Objektivi i Politikës së Programit**

- Përmirësimi i jetës i familjeve në nevojë dhe grupet e pafavorizuara.

\*Rimbursimi I familjeve të pastreha për bonus qiraje në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" me vlerë 300,000 lekë.

### **Investimet**

Nr.	Programi	Emertimi investimeve sipas objekteve	Vlerë projekti	Vlerë Kontrate	2026 TOTAL Plan	Fakt
1	AD112	Permiresimi i Banesave ekzistuese per familjet ne nevoje (komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara) ( Bashkefinancim)		3,291,132	3,291,132	-
2	AD112	Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e re (Ndertim i fushave te basketbollit dhe njesitë Patos )	15,912,104		16,036,060	123,956
3	AD112	Rikonstruksion i aneksit te stadiumit Patos	100,000		100,000	-
5	AD112	Rikonstruksion Kopeshtit me dreke Patos		8,353,391	8,353,391	-
6	AD112	Rikonstruksion I shkolles sotir capo zharrez dhe ndertim I palestres( oponence + mbikyres +koladues) Bashkefinancim		7,847,381	7,847,381	-
7	AD112	Mbikqyres + Koladues Rikonstruksion dhe adaptim ish kopeshtit Verbas ne qender ambulatore		56,063	56,063	-
9	AD112	Mobilim + pajisje kopështi me drekë	8,000,000		8,000,000	-
10	AD112	Rikonstruksioni i Kopështit nr . 2	247,318		247,318	-
11	AD112	Mbikqyres+ Kolaudues Rikonstruksion I magazines ne rrugen "Gani Banaj" me objekt me funksion sherbime artizanale(Bashkefinancim)		35,597	35,597	-
<b>SHUMA PROGRAMI ARSIMI, KULTURA SPORTI DHE ÇËSHTJET SOCIALE</b>					<b>43,966,941</b>	<b>123,956</b>

- ❖ Mbi relaizimin e Programit.

1. Aktivitete nga biblioteka: Lexuesit më të mirë të vitit 2025, krijimtaria e shkrimtarit Lili Gogu, konkurs me poezi të shkruar nga Lasgush Poradeci.
2. Aktivitete artistike nga QKF: konkursi i pikturës, krijimi i çantave prej rrobe dhe qëndisja e tyre, aktiviteti kushtuar festave të 7-8 Marsit, koncert me këngë e kërcime dhe ekspozita me vizatime “Fëmijët dhe Kryqi i Kuq”.
3. Aktiviteti festiv për Ditën e Verës.
4. Ceremonia zyrtare e 82-vjetorit të Betejës së Margëlliçit.
5. Aktiviteti “Në nder të grave të komunitetit”.
6. Ceremonia zyrtare e Ditës së Dëshmorëve.
7. Aktivitet (koktej) me veteranët dhe familjarë të dëshmorëve “Beteja e lirisë”për Ditën e Dëshmorëve.
8. Kampionate sportive nga QKF: kampionati i bilardos, kampionati i volejbollit për vajza, kampionati i volejbollit për djem.
9. Aktivitete artistike për brezin e ri.

#### Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit bazë (9-vjeçar) dhe parashkollor

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor	Raporti në % i numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve 3 - 6 vjeç	100	85%
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë	15	14
Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë të parashkollorit	15	14
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	15	14
Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësimor në arsimin parashkollor	15	14

*Ofrimi i sigurisë dhe garantimi i kushteve optimale për rritjen e fëmijëve në çerdhe , kopshte dhe arsimin bazë*

Emri i produktit	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Shërbime me gaz për gatimin e ushqimit të fëmijëve në kopshte	numër	12	4
Shërbime ushqimore për rritjen e fëmijëve në kopsht & çerdhe	numër	12	4
Shërbime ngrohje me dru dhe pelet të nxënësve në shkolla e kopshte	numër	5	3
Shërbime ngrohje me naftë të nxënësve në shkolla	Numër	5	3
Shërbime higjieno-sanitare të nxënësve në shkolla e kopshte	numër	12	4

Emri	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Edukatore në çerdhe	numër	5	5
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	400	324
Kapaciteti maksimal i akomodimit(numri i shtretërve në fjetore)	numër	110	108
Klasa në sistemin e arsimit bazë	numër	116	93
Klasa në sistemin parashkollor	numër	27	21
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit bazë	numër	170	172
Mësues në sistemin parashkollor	numër	40	34
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	numër	1500	1302
Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç	numër	400	324

\**Shënim:* Nr. i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç i referohet fëmijëve që frekuentojnë Kopshtet në varësi të bashkisë Patos.

### Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit të përgjithshëm (mesëm)

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve në klasë	25	22
Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	13	11
Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në arsimin e mesëm	Raporti në % i ndërtesave të mirëmbajtura / rikonstruara ndaj totalit të ndërtesave funksionale të arsimit të mesëm	100	70
Frekuentimit në arsimin e mesëm	Numri i nxënësve	350	330

### Përmirësimi i kushteve për zhvillimin cilësor të procesit mësimor-edukativ në arsimin e mesëm

Emri I produktit	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Shërbime ngrohje me pelet druri të nxënësve në shkollat e mesme	numër	5	3
Shërbime ngrohje me naftë të nxënësve në shkollat e mesme	numër	5	3
Shërbime higjieno-sanitare të nxënësve në shkollat e mesme	numër	12	3
Trajtim me bursë nxënësit e arsimit të mesëm profesional	numër	10	8
Nxënës të trajtuar me bursë	numër	40	36

*\*Shënim:* Bashkia bën vetëm proceduarat për trajtimin me bursë nëpërmjet miratimit në Këshillin e Bashkisë, dhe i dërgon të dhënat në shkollat profesionale përkatëse të nxënësve për trajtimin nga ana e tyre nëpërmjet fondeve financiare të akorduara nga MAS.

Emri	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Klasa në sistemin e arsimit të mesëm	numër	20	15
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm	numër	75	46
Ndërtesa funksionale të arsimit të mesëm	numër	3	3
Nxënës ekselentë	numër	10	10
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9 vjeçar)	numër	264	260
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit të mesëm (klasat 10 - 12)	numër	200	99
Nxënës të regjistruar në klasën e 10 të arsimit të mesëm	numër	150	111
Nxënës të arsimit të mesëm profesional që trajtohen me bursë	numër	10	10
Nxënës të arsimit parauniversitar që trajtohen me bursë	numër	30	36

*Trajtimi i rasteve të dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje*

Emri	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Raste dhune të trajtuara me shërbim psikologjik	numër	10	0
Raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar	numër	15	6
Familje/individë që kanë përfituar 6% nga të ardhurat e bashkisë	numër	30	21

Emri	Njesia matese	Plani	Fakt
Numri total i rasteve të dhunës të identifikuar	numër	30	17
Numri total i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuar	numër	10	15
Numri i familjeve/individëve në vështirësi ekonomike të identifikuar	numër	170	150
Raste dhune të trajtuara me shërbim psikologjik	numër	10	0
Raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar	numër	15	6
Familje/individë që kanë përfituar 6% nga të ardhurat e bashkisë	numër	30	21
Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social	numër	6	6
Individë AK që përfitojnë trajtim	numër	880	880

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Identifikimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i viktimave të dhunës në familje të identifikuar.	30	17
Identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuar.	10	15
Identifikimi i familjeve në vështirësi ekonomike dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i familjeve në vështirësi ekonomike të identifikuara.	170	150

- Përfitime në natyrë të struktura dhe terrene për veprimtari sportive,
- Hapësira publike çlodhëse dhe argëtuese ;
- Mirembajtja e terreneve sportive.

Indikator	Njesia masese	Plan	Fakt
Siperfaqe	Siperfaqia e ambjenteve sportive dhe argetuese ne m2	1000	950
Mirembajtja e terreneve për veprimtari sportive	Numri i terreneve sportive të mirëmbajtura	4	4

Të dhëna

Emri	Njesia masese	Plan i rishikuar	Fakt
Ekipi i futbollit meshkuj të rritur	numër	22	22
Ekipi i futbollit meshkuj të vegjël	numër	90	85
Ekipi i Boksit meshkuj të rritur	numër	13	12
Ekipi i Boksit meshkuj të vegjël	numër	10	8
Ekipi i volejbollit femra të vegjël	numër	14	12
Trajner ekipi të riturve Futboll	numër	2	2
Trajner ekipi të vegjël Futboll	numër	2	2
Trajner ekipi të vegjël Boks	numër	1	1
Trajner ekipi të vegjël Volejball	numër	1	1
Ndeshje futbollit per te rritur	numër	19	18
Ndeshje futbollit per te vegjel	numër	40	37
Ndeshje Volejbollit per vajza	numër	3	3

Ekipi i futbollit Albpetrol siguroi ngjitjen në Kategorinë e Dytë të Futbollit duke përmbushur një nga objektivat tij. Gjithashtu Ekipi i Boksit për të rinj deri në moshën 17 vjeç fitoi medalje argjendi në kampionatin Kombëtar të Boksit për të rinjtë që u zhvillua në Fier.

## V. III.5 PROGRAMI PUNË PUBLIKE

Ky program përfshin por nuk kufizohet në funksionet e qeverisjes vendore si “Menaxhimi i Mbetjeve”, “Shërbimet Publike Vendore”, “Ndriçimi i Rrugëve”, “Transporti Publik”.

### ➤ RAPORTI M 2 : SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

- Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	Në lekë		
		Plan	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	80,396,138	36,362,559	25%
Sigurimet Shoqërore	601	12,994,423	6,018,471	46%
Mallra dhe shërbime	602	60,439,357	14,059,519	23%
Të tjera transferta korrente të brendshme	604			0%
Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	606	1,881,911	91,814	5%
Kapitale të Patrupëzuara	230			0%
Kapitale të Patrupëzuara	231	79,047,135	16,415,274	21%

#### **Totali**

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
234,758,964	72,947,641	31 %

#### Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Produktet	Njesia masese	Plani rishikuar	Fakt	Shpenzime Plan	Shpenzime Fakt
Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane	ton mbetje	4,000	1,000	53,461,598	16,423,404
Pastrimi i rrugëve dhe parqeve	m2	125,000	45,000	735,000	0
Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	numër i depozitimeve	1,200	332	11,900,000	410,289
Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale	ton mbetje	1,000	170	110,000	0
Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelbërimit, varrezave	Numër	57	57	46,440,198	24,628,450
Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes së Ndriçimit Publik	Numër	3	3	2,212,819	467,785
Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur	km	11		2,571,911	959,281
Rrjeti i ndriçimit rrugor publik rural i mirëmbajtur	Km	11		500,000	0
Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave	m2	270,000	70,000	565,000	
Rrugë Urbane e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar	Km	4		72,781,108	25,172,895
Sipërfaqe e Gjelbërt e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar	m2	42,000	40,000	2,138,000	
Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar	km linear	4		5,671,195	0
Objekte publike të mirëmbajtura	Numër	75		200,000	
Rrjeti i ndriçimit rrugor publik urban i mirëmbajtur	Km	25	2.7	27,700,000	4,291,507
Dekori i Qytetit	numër	11		2,100,000	
Shërbimi i Transportit Publik	numër	1	1	4,216,135	594,030

➤ **RAPORTI M 3 : SHPENZIMET DHE SASITË E PRODUKTEVE**

➤ **Investimet**

Nr.	Programi	Emertimi investimeve sipas objekteve	Vlerë projekti	Vlerë Kontrate	2026 TOTAL Plan	Fakt	Mbetje
1	AE112	Konteniere per 3 njesite	10,295,310		10,295,310	-	10,295,310
2	AE112	Pajisje pune	150,000		150,000	-	150,000
3	AE112	Blerje Asfalto-Beton per shtrim rruges	30,000,000	17,334,630	47,334,630	16,415,274	30,919,356
4	AE112	Pajisje zyre + sietmin e sigurimit	100,000		100,000	-	100,000
5	AE112	Blerje Peme dekorative	600,000		600,000	-	600,000
6	AE112	Ndricim rrugor (Baze materiale)	12,600,000		12,600,000	-	12,600,000
7	AE112	Ndertim te trotuareve dhe shesheve te pallateve (Blerje Baze Materiale)	140,515	5,470,680	5,611,195	-	5,611,195
8	AE112	Korrese Bari Profesionale	400,000		400,000	-	400,000
9	AE112	Ndertim i Kuartallit te RI ne varrezat e Qytetit	200,000		200,000	-	200,000
10	AE112	Stola për lulishtet e qytetit dhe rrethinat	500,000		500,000	-	500,000
11	AE112	Ndërtim kabine me parametra 20 kv	500,000		500,000	-	500,000
12	AE112	Shtrim rruge ne Lagjen "Mustafa Matohiti"	756,000		756,000	-	756,000
<b>SHUMA PROGRAMI PUNET PUBLIKE</b>					<b>79,047,135</b>	<b>16,415,274</b>	<b>62,581,861</b>

**Përshkrimet dhe pema e programit e funksioneve që përbëjnë programin janë si më poshtë:**

**🚦 FUNKSIONI “RRJETI RRUGOR RURAL” NJËSIA SHPENZUESE:N.SH.P.**

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04520	Rrjeti rrugor rural	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore;</li> <li>• Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;</li> </ul>

**Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale.**

#### ***Qëllimi i Politikës së Programit***

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës . Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe urbane për të siguruar akses të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë zhvillimin e rrugëve, urave dhe strukturave të tjera të transportit.*

#### ***Objektivi i Politikës së Programit***

- *Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit*

Ky funksion në bazë udhëzimit të PBA-së nga Ministria e Financave përfshin edhe të gjitha investimet në infrastrukturë dhe për këtë arsye ne e kemi ndarë këtë programi në 2 (dy) njësi shpenzuese , në njësinë shpenzuese Bashkia Patos dhe njësinë shpenzuese Nd. e Shërbimeve Publike ku kemi vendosur kryesisht shpenzimet që janë nga transfertat pakushtëzuar sektoriale për këtë program. Tashmë rrjeti rrugor urban i qytetit lidhet me rrjetin kombëtar rrugor nëpërmjet unazës kryesore dhe unazës rurale të qytetit.

### **FUNKSIONET SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE , NDRIÇIMI I RRUGËVE . NJËSIA SHPENZUESE:N.SH.P.**

<b>Vështrim i përgjithshëm</b>		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin;</li> <li>• Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve;</li> <li>• Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;</li> </ul>

### ***Qëllimi i Politikës së Programit***

- *Përmirësimi i hapësirave publike dhe sistemit të ndriçimit, Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberuara, parqeve, gjelberim rrugor, trotuare . Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike . Mirëmbajtja e objekteve arsimore dhe administrative.*

### ***Objektivi i Politikës së Programit***

- *Përmirësimi , shtimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike. Mirëmbajtja e objekteve publike dhe arsimore dhe rregullimi i infrastrukturës publike.*
- *Mirëmbajtje e ndriçimit rrugor në 3 njësitë administrative.*

### **➤ *Vështrim i përgjithshëm i funksioneve.***

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe objektivave të Politikave të Programit në ofrimin e shërbimeve, përmirësimit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore sipas standarteve në të gjitha komponentet e saja të shtrirë në qytet dhe në periferi për t'u mundësuar qytetarve shërbim në kohë, që t'u ofrojmë shërbime në mirëmbajtjen dhe përmirësim e rrugëve, trotuareve, mirëmbajtje e objekteve arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe), riparime, lysterje, merementime të ambienteve jashtë dhe brenda institucioneve, mirëmbajtje e rrjetit hidraulik si dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit rrugor dhe dekorit të qytetit , gjithashtu dhe në mirëmbajtjen dhe shtimin e zonave të reja me ndriçim rrugor.

## **FUNKSIONI TRANSPORTI PUBLIK . N.SH.P.**

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve të transportit publik në teritorin e pambuluar nga transporti publik privat		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04570	Transporti publik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal;</li> <li>• Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.);</li> <li>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal.</li> </ul>

#### **Qëllimi i Politikës së Programit**

*Sigurimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të transportit publik që plotëson nevojat e qytetarëve për lëvizje të lehtë, të sigurt dhe të përballeshme, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe aksesin në transport.*

#### **Objektivi i Politikës së Programit**

- *Aksesi në transporti publik për të gjithë qytetarët.*

### FUNKSIONI MENAXHIMI I MBETJEVE

Vështrim i përgjithshëm		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit

05100	Menaxhimi i mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;</li> <li>• Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;</li> <li>• Pastrimi i rrugëve, parqeve etj.</li> </ul> <p><b>Njesia shpenzuese Bashkia Patos, Ndërrmarrja e menaxhimit të mbetjeve/Pastrimit/Gjelbërimit/varreza</b></p>
-------	----------------------	--

**Ky funksion mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe nga burimet e veta.**

***Qëllimi i Politikës së Programit***

- *Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane. Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të efektshëm të menaxhimit të mbetjeve dhe mbajtja e një ambjenti të pastër.*

***Objektivi i Politikës së Programit***

- *Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimin.*
- *Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane dhe rurale*
- *Pastrimi i rrugëve dhe parqeve*
- *Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve*

***Vështrim i përgjithshëm i funksionit.***

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe Objektivave të Politikave të Programit me moton “Për një qytet të pastër” duke venë në efikasitet plot Asetet e burimeve njerezore, mjetet e transportit dhe burimet financiare për ofrimin e shërbimeve me cilësi sipas standarteve bashkëkohore, në mbledhjen e mbetjeve urbane organike në tre njësi administrative, nga kontineret dhe pikat fikse duke siguruar një ambjent të pastër dhe pa ndotje, në shtrirjen e shërbimeve publike me mbledhjen e mbetjeve urbane në zonat periferike dhe informale, në mbajtjen pastër të rrugëve kryesore, dytesore ,rrugë, shesheve të pallateve, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e tjera.

**❖ MBI REALIZIMIN E PROGRAMIT.**

1. Rrjet ekzistues i ndriçimit publik i mirëmbajtur (2.7 km) për vitin 2026, në të gjithë territorin e Bashkisë Patos duke përfshirë edhe dy Njësitë Administrative.

2. Rrugë të rikonstruara me asfalto-beton (13.955 m<sup>2</sup>)

RRUGË TË PËRFUNDUARA				
Nr	RRUGËT E SHTRUARA ME ASFALTOBETON	Vendndodhja	Gjatesi rruge	Sip. në m <sup>2</sup>
1	Rruga “Te blloku parafabrikat”	Nj.Adm. Patos,		736 m <sup>2</sup>
2	Rruga “Batalioni Çamëria”	Nj.Adm. Patos,	100 ml	300 m <sup>2</sup>
3	Rruga “Enriko Veizi” mbrapa 6-katëshit	Nj.Adm. Patos, Qender	190 ml	760 m <sup>2</sup>
4	Rruga “Dhimitër Dede”	Nj.Adm. Patos,	560 ml	2240 m <sup>2</sup>
5	Degezim Rruga Sotir Xoxe dhe Rrapi Tiku	Nj.Adm. Patos,	235 ml	743 m <sup>2</sup>
6	Rruga Hoxhaj Verbas	Nj.Adm. Zharrëz fshati Verbas	290 ml	906 m <sup>2</sup>
			<b>Total</b>	<b>5,685 m<sup>2</sup></b>

RRUGE QE JANE NE PROCES( shtruar vetem pjesa e cakullit) për vitin 2026				
Nr	RRUGËT	Vendndodhja	Gjatesi rruge	Sip. në m <sup>2</sup>
1	Rruga tek Kinemaja e vjeter	Nj.Adm. Patos,	350	1090 m <sup>2</sup>
2	Rruga Ymeraj	Gjinoqar	1000 ml	3300 m <sup>2</sup>
3	Rruga Xhelaj	Nj.Adm. Patos,Rreres	260 ml	780 m <sup>2</sup>
4	Rruga Ferraj	Zharrez	450 ml	1350 m <sup>2</sup>
5	Rruga Xhorraj	Siqece	500 ml	1250 m <sup>2</sup>
6	Rruga Myftaraj	Rruzhdie	200 ml	500 m <sup>2</sup>
			<b>Total</b>	<b>8,270 m<sup>2</sup></b>
			<b>Gjithsej</b>	<b>13,955 m<sup>2</sup></b>

### 3. Mirëmbajtje të rrjetit KUZ /KUB (1746 ml)

✓ Lagjja e Re, te vreshti, mirmbajtje KUZ	100 ml përfunduar
✓ Në Marglliç Rruga e lapidarit, mirmbajtje KUB	200 ml
✓ Në Gjinoqar, Rruga Ymeraj KUZ/KUB	200 ml
✓ Në Siqecë, Rruga Xhoraj, mirmbajtje KUB	12 ml
✓ Në Rrerës, Ruga Hoxhaj, mirmbajtje KUZ/KUB	24 ml
✓ Në Velmish, mirmbajtje KUZ	110 ml
✓ Në Dukas Kripallarë, mirmbajtje KUZ	200 ml vazhdon.

### 4. Mirëmbajtje të mureve mbajtës (72 ml)

✓ Mirëmbajtje mur mbajtës në rrugën Late bregu Dukas	20 ml përfunduar
✓ Mirëmbajtje mur mbajtës në rrugën Heronjtë e Linasit	22 ml përfunduar
✓ Mirëmbajtje mur mbajtës në Lagjjen e Re	10 ml në proces
✓ Mirëmbajtje mur mbajtës në Dukas, Lagjja Velmish	20 ml në process

Realizime të tjera gjatë 4-mujorit:

1. Shtrim me pllaka tek sheshi në lagjjen 1 maji për të cilin jemi në proces punimi.
2. Shtrim me pllaka tek sheshi në lagjjen e Re dhe kemi përfunduar 100 m2.
3. Rrethimi i kopështit në Njësinë Administrative Zharrëz.
4. Zëvendësimi i kontenierëve dekorativ dhe stolave në gjithë territorin.

### Grumbullimi i mbetjeve në platformat ekzistuese.

- Zharrëz - 15 pika;
- Patos - 25 pika
- Oficinë - 2 pika dhe zëvendësim I tre kontenierëve tek Lapidari.
- Verbas - 2 pikë,
- Shtëpia e Bardhe (rruga kryesore) -1 pikë
- Konfiskati (Pularia) - 1 Pikë

Në grumbullimin e mbetjeve urbane punohet me 2 mjete teknologjike dhe 2 kamion vetëshkarkues :

- Sipërfaqja e pastruar në territorin e Bashkisë Patos është 45,000 m<sup>2</sup> për 4-mujorin e vitit 2026..

Çdo ditë bëhet grumbullimi i mbetjeve urbane nga 318 kontinerët e mëdhenj, të shpërndarë në tre Njësitë Patos, Zharrëz, Ruzhdie. Gjatë kësaj periudhe janë vendosur 2 kontenierë plastik (lagja e Re te Cirku) dhe 1 kontenierë metalik të rinj në vendgrumbullimet (lagja e Re – te pompa e ujit) Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

- ❖ Mirëmbajtjen dhe korrjen e barit sipas sipërfaqeve të gjelbëruara .
- ❖ Korrje bari në Kopështe , Shkolla, rrugëve kryesore dhe dytësore .
- ❖ 23 parcela të varrezave publike të qytetit dhe Njësi Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie
- ❖ Gjithashtu Sek. i Gjelbërimit mbulon dhe rrugën nacionale Patos- Zharrëz- Kthesa e Patosit deri në Unazën e qytetit ku bëhet prerja e barërave gjatë kanaleve anësore .
- ❖ Kemi shtrirë shërbime të reja në lagjet dhe rrugët e Njësisë Zharrëz dhe Ruzhdie.
- ❖ Mirëmbajtjen e 3491 pemëve, 2735 rrënjë trëndafila, 634 lule shkurreve dekorative dhe 1700 ml ligustër gardh të cilat ndodhen në lulishtet, trotuaret shkollat në tre njësitë e Bashkisë Patos.
- ❖ Pastrimi i barit dhe punimi i pemëve përgjatë gjithë rrugëve të qytetit të Bashkisë Patos .
- ❖ Prerjet e pemëve, çarja e drurëve dhe shpërndarja e tyre në Institucionet Arsimore dhe parashkollore sipas kërkesave të ardhura në NMMPGJ.
- ❖ Pastrimi i degëve të pemëve nga të gjithë bazat e kontinierëve.

Gjatë kësaj periudhe 4-mujore mund të themi se kemi arritur një situatë të kënaqshme për ti shërbyer komunitetit, duke përmbushur objektivat e vendosura sipas buxhetit. Gjithsesi do të vazhdojmë me ritme akoma më të mira dhe me një vision të qartë i cili do të jetë gjithpërfshirës në shërbim të qytetarëve tanë në 4-mujorët në vazhdim.

Vështrim i përgjithshëm		
“Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04910	Fondi Rezerve	<ul style="list-style-type: none"> <li>“Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit. <b>Njesia shpenzuese Bashkia Patos</b></li> </ul>

Fondi rezervë është hapur si program në vitin 2025 sipas udhëzimeve të fundit.

Në buxhetin e vitit 2026, Fondi rezervë, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, është parashikuar në shumën 3.066,000 lekë , **dhe përbënë afërsishtë 1 % të totalit të buxhetit.**

**Fondi Rezervë do të përdoret: Qëllimi i Politikës së Programit**

- *Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.*

**Objekti i Politikës së Programit, Produkti**

#### FONDI KONTIGJENCË

Vështrim i përgjithshëm		
“Fond kontigjencë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04940	Fondi Kontigjencë	<ul style="list-style-type: none"> <li>“Fond kontingjence” është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. <b>Njesia shpenzuese Bashkia Patos</b></li> </ul>

- **Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:**

Në lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	Plan	Fakt	Realizimi Fakt
Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	609	6,132,000	0	0%

**Totali**

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
6,132,000		%

Produktet	Njesia masese	Plani rishikuar	Fakt	Shpenzime Plan	Shpenzime Fakt
Fondi Rezervë	Numër	1		3,066,000	0
Fondi Kontigjencë	Numër	1		3,066,000	0

**Raporti Mon 2 dhe Mon 4 i monitorimit në SMBV.**

Fondi kontigjencës është hapur si program në vitin 2025 sipas udhëzimeve të fundit. Në buxhetin e vitit 2026, Fondi kontigjencës, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, është parashikuar në shumën 3.066,000 lekë *dhe përbën afërsisht 1 % të totalit të buxhetit.*

**Qëllimi i Politikës së Programit**

*Fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese.*

**Produkti**

*Fondi kontigjencë.*

Për këtë katërmujor nuk ka pasur VKB për ndryshime në fondin rezervë dhe kontigjencë.

Përgjegjës për Planifikimin dhe Monitorimin e Buxhetit.

**Andi Kola**



**Sekretare e GMS**

Drejtoreshë Finance  
**Mimoza Shtëmbari**



**Kordinatori i GMS**

Nënkryetare e Bashkisë

**Ana Sauli**

